



Buletin informativ
i Gjykatës Themelore të Prizrenit
maj – korrik 2017

Buletin informativ “Gjykatë e Hapur” *
Nr. 8, gusht 2017
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.gjyqesori-rks.org

PËRMBAJTJA

FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

“Drejtësia nuk është qëllim në vetvete.
Ajo jepet për njerëzit dhe duhet të perceptohet
prej tyre si e tillë.”

STORIE E SUKSESIT

Gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prizrenit
ligjëruan para studentëve të fakultetit juridik
temën “Mbrotjtja dhe realizimi i të drejtave
statusore-familjare në Gjykatë”

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Komunikatat për media të Zyrës për Informim

INTERVISTË E SHKURTË

Shpresa Emra – Gjyqtare në Gjykatën Themelore
të Prizrenit

SI TI QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

A e dini se...?!

Kontakttoni Gjykatën Themelore të Prizrenit



FJALA E KRYETARIT TË GJYKATËS

Të nderuar lexues,

Drejtësia nuk është qëllim në vetvete. Ajo jepet për njerëzit dhe duhet të perceptohet prej tyre si e tillë. Njerëzit duhet ta ndjejnë thellë që drejtësia është e pavarur, e paanshme, e ndershme, e barabartë për të gjithë dhe e përgjegjshme. Besimi i publikut tek drejtësia është një nga vlerat më të çmuara që kultivohet në një shoqëri demokratike.

Përpjekje për avancimin e frymës së bashkëpunimit midis qytetarëve dhe gjykatës është edhe vazhdimi i publikimit të buletinit nr.8 që ka bërë një hap pozitiv sa i përket informimit të qytetarëve me sistemin e drejtësisë në përgjithësi dhe punën e gjykatës në veçanti. Ky publikim periodik do të ofroj informacione për punën e gjykatës, statistikën e trajtimit të lëndëve, aktivitetet dhe projektet, qasjen e qytetarëve në gjykatë, përfshirjen e mediave dhe të tjera në shërbim të transparencës dhe llogaridhënies karshi qytetarëve.

Në Gjykatën Themelore të Prizrenit kanë filluar punën edhe shtatë gjyqtar të rinj prej të cilëve dy janë sistemuar në gjykatën Themelore të Prizrenit – dega në Suharekë të cilët do t'i ndihmojnë gjykatës në reduktimin e numrit të madh të lëndëve. E suksesshme është edhe pranimi i katër trajnerëve të cilët trajnojnë punonjësit e gjykatës në projektin SMIL (Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve) të cilët janë punësuar prej autoritetit kontraktues IMG e sponsorizuar nga Qeveria Norvegjeze me qëllim që ta ndihmojnë gjyqësorin në digjitalizimin dhe menaxhimin e lëndëve me objektiv për të rritur efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien karshi qytetarëve. Përveç suksesit që ka kjo gjykatë ka edhe sfidat me të cilat po ballafaqohet çdo ditë. Njëra ndër sfidat kryesore është mungesa e bashkëpunëtorëve profesional, mungesa e stafit administrativ, si dhe mungesa e përkthyesve e të cilat paraqesin një sfidë sa i përket punës së kësaj gjykate.

Gjykata Themelore e Prizrenit është gjykatë e hapur, e cila do të vazhdoj të investojë në forcimin e standardeve profesionale dhe të transparencës.

Ymer Hoxha

Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren

STORIE E SUKSESIT

Gjyqtarët e Gjykatës Themelore të Prizrenit ligjëruan para studentëve të fakultetit juridik temën **“Mbrojtja dhe realizimi i të drejtave statusore-familjare në Gjykatë”**.

Me ftesë të Universitetit Publik “Ukshin Hoti” në Prizren, përkatësisht Fakultetit Juridik të këtij universiteti, me datën 25.05.2017, gjyqtarët e Divizionit Civil të Gjykatës Themelore në Prizren, **Lumni Sallauka, Valon Totaj dhe Arsim Hamzaj**, kanë mbajtur një ligjëratë para studentëve të Fakultetit Juridik të cekur më lartë, me temë: “Mbrojtja dhe realizimi i të drejtave statusore-familjare në Gjykatë”

Gjatë ligjërimit pjesëmarrësit (studentët) u njoftuan me procedurat gjyqësore në zgjidhjen e kontesteve martesore-familjare në Gjykatë, siç janë: zgjidhja e martesës me shkurorëzim, besimi i fëmijëve të mitur, pagimi i alimentacionit, caktimi i kontakteve personale të prindit me fëmijët, vërtetimin e atësisë dhe amësisë, kundërshtimin e atësisë dhe amësisë, çështjen e ndarjes së pasurisë së bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës etj.

Ligjërimit - Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive, ku studentët parashtruan pyetje rreth zbatimit në praktikë të dispozitave ligjore të Ligjit për Familjen, Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe legjisacionin tjetër të zbatueshëm në kontestet martesore-familjare.

Përfitues të kësaj ligjërate ishin studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit Publik ‘Ukshin Hoti’ në Prizren dhe disa profesor të këtij fakulteti. Gjithashtu ishte kërkesë e këtyre të fundit që edhe në të ardhmen të vazhdohet me bashkëpunime të tilla për çështje nga praktika gjyqësore, të cilat u konsideruan si shumë të nevojshme për studentët e Fakultetit Juridik të cekur më lartë.



Studentët e komunitetit boshnjak të Kolegjit “Biznesi” vizituan Gjykatën e Prizrenit.



Me datën 14.04.2017, në orën 11:00, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan studentët e komunitetit boshnjak të Kolegjit “Biznesi”.

Vizita ka karakter të praktikës për studentet e drejtimit juridik, nën përcjelljen e profesorit të tyre. Studentët u pritën në zyrën e Kryetarit të kësaj gjykate ku Kryetari prezantoi strukturën e gjykatës, punën që bënë gjykata, sfidat dhe bashkëpunimin e gjykatës me qytetarët, mënyrën e komunikimit me qytetarët dhe mjetet e zhvilluar për krijimin e një lidhje më të mirë me qytetarët ku edhe vazhduan me diskutimet e hapura.

Në pjesën e dytë të takimit, studentet patën mundësi të njihen me objektin e gjykatës, me punën që bënë secila zyre, me sallat e seancave gjyqësore, dhomën e dëshmitarëve dhe materialet informuese të gjykatës. Studentët patën mundësi ta përcjellin edhe një seancë gjyqësore që u mbajt në objektin e kësaj gjykate.

Gjykata do të vazhdoj traditën e bashkëpunimit me qytetarët, me shkollat e qytetit dhe të rajonit.

VIZITË NË DEGËN E GJYKATËS THEMELORE NË DRAGASH



Më datë 26.04.2017 zëdhënësja e Gjykatës Themelore të Prizrenit Afërdita Kicaj pati një takim pune me gjyqtaren mbikqyrëse të Gjykatës së Dragashit, Sabahete Kurteshi dhe me administratorin e kësaj gjykate. Pjesë e këtij takimi ishin edhe praktikanti i Zyrës për Informim Publik si dhe përfaqësues i OJQ-së “EC Ma Ndryshe”. Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte njohja më për së afërmi me mbarëvajtjen e punës së kësaj gjykate dhe mundësinë e qasjes më të lehtë të qytetarëve në gjykatë.

Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe çështje tjera të rëndësishme. Ndër të tjera u pa edhe këndi për informim publik. Ky kënd u pajis me Buletin Informativ të Gjykatës Themelore të Prizrenit i cili publikohet çdo tre muaj, dhe me mjete të tjera të transparencës si: Strategjia e Komunikimit, “Si t’i qasemi gjykatës”. U njoftua edhe me spotin televiziv i cili shfaqet në RTK3, faqen në facebook “Gjykatë e Hapur” dhe web portalin e gjykatës www.gjyqesorirks.org.

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela e mëposhtme paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore të Prizrenit për gjashtë mujin e parë të vitit 2017, si ato të trashëguara në fillim të vitit 2017, të ardhura, lëndët në proces, lëndët që janë përfunduar në këtë gjashtë mujin dhe ato të mbetura në fund të gjashtë mujit të parë të vitit 2017. Statistikat e punës për gjashtë mujin e parë të vitit 2017 janë dëshmia e radhës numerike e përkushtimit maksimal të gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Gjykata Themelore Në Prizren	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të 2017	Lëndët e ardhura gjatë VI - MUJORIT 2017	Gjithsej lëndët në punë gjatë VI - MUJORIT 2017	Lëndët e kryera gjatë VI - MUJORIT 2017	Lëndët e mbetura në fund të VI - MUJORIT 2017	Perqindja e lendeve të zgjidhura të VI - MUJORIT 2017
Dep. Për Krime Të Rënda	Penale	143	68	211	90	121	132,35
	Paraprake	214	62	276	75	201	120,97
Dep. i Përgjithshëm	Penale	3832	1436	5268	1254	4014	87,33
	Paraprake	669	311	980	81	899	26,05
	Civile	1204	819	2023	803	1220	98,05
	E.Civile	9257	987	10244	1701	8543	172,34
	E.P. Me Burg	103	50	153	111	42	222,00
	E.P. Me Gjobë	999	361	1360	516	844	142,94
	Të Ndryshme	0	6838	6838	6838	0	100,00
	Trashegimore	35	33	68	53	15	160,61
	Jashtkontestimore	383	394	777	287	490	72,84
Dep. Për Të Mitur	Penale Para Kolegjit	218	70	288	59	229	84,29
	Pregaditore	89	73	162	80	82	109,59
Divizioni i Kundërvajtjes	Kundërvajtje	12137	5467	17604	12159	5445	222,41
TOTALI		29283	16969	46252	24107	22145	142,06

GJYKATA NË MEDIA

Gjatë gjashtë mujit të parë të vitit 2017, Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar rreth 44 komunikata për media, të cilat kanë për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe të shqiptimit të dënimeve si dhe për seancat që janë të hapura për publikun. Komunikatat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha televizionet lokale në pothuaj të gjitha rastet, me qëllim njoftimin e publikut për seancat gjyqësore që mbahen në gjykatë. Televizioni i Prizrenit, TV Opinioni, TV Besa, Prizren Press, Radio Kosova, Gazeta Zëri dhe Kallxo.com, kanë qenë mediat të cilat kanë përfshirë më së shumti kumtesat dhe ngjarjet e kësaj gjykate.

INTERVISTË E SHKURTË

“Që të forcohet besimi i qytetarëve duhet të punohet me përkushtim, të merren vendime të drejta të bazuara në ligj dhe në kohë të arsyeshme.”



SHPRESA EMRA

Gjyqtare në Gjykatën Themelore të Prizrenit

1. Sa kërkon angazhim puna e juaj si gjyqtare ne Departamentin e Përgjithshëm – penal si dhe si Koordinator e Forumit të gjyqtarëve dhe Prokuroreve të Regjionit të Prizrenit?

Puna ime si gjyqtare e Departamentit të Përgjithshëm në referatin Penal kërkon angazhim dhe përkushtim pasi që jam e ngarkuar me shumë lëndë si edhe kolegët tjerë në këtë Departament. Vetëm me organizim dhe planifikim të punës arrihen rezultatet e mira dhe puna rrjedh në mënyrë të duhur. Gjithashtu jam edhe Koordinator e Forumit të Gjyqtareve dhe Prokuroreve për Regjionin e Prizrenit ku jam e angazhuar në aktivitete të këtij Forumi me qëllim të promovimit të rolit dhe pozitës së gjyqtareve dhe prokuroreve të Regjionit të Prizrenit. Koordinimi i punës si gjyqtare dhe si Koordinator e Forumit kërkon angazhim shtesë dhe planifikim të mirëfilltë, në mënyrë që të përmbushen obligimet që rrjedhin nga këto dy punë. Gjyqtari është i pavarur në punën e tij dhe i pavarur në planifikim të punëve dhe kjo më ndihmon që vet të organizoj dhe të arrij sukses në të dy fusha të veprimtarisë.

2. Cilat lëndë gjyqësorë mund t’i quani më problematike dhe si i tejkaloni vështirësitë në zgjidhjen e tyre?

Nuk mendoj se ka lëndë problematike, secila lëndë e ka rëndësinë e vet dhe asnjëherë nuk mundemi paraprkishtë të përcaktojmë se ndonjë lëndë do të kërkon përkushtim më tepër se lënda tjetër. Lënda mundet me qenë me shumë persona dhe me shumë vepra dhe si e tillë kërkon më shumë punë e angazhim, por kjo nuk do të thotë se është problematike, është vetëm më voluminoze dhe mund të zgjas më shumë përfundimi i saj.

3. Çfarë mendoni ju, sa transparente është puna e gjykatave në Kosovë?

Puna e gjykatave në Kosovë, posaçërisht e gjykatës sonë mendoj se është transparente pasi që të gjithë kanë të drejtë qasje në gjykatë, kanë informata nëpërmjet mjeteve elektronike, kemi faqen tonë zyrtare, kemi informata tjera të cilat janë të publikuara në faqen e Këshillit Gjyqësor, kemi bashkëpunim të mirë me disa organizata joqeveritare për monitorim të gjykimeve, kryetari i gjykatës e ka ditën e pranimit të palëve ku të gjithë të interesuarit mund të informohen për çështjet të cilat janë të interesuar.

4. A ekzistojnë mekanizma për t’u ofruar siguri gjyqtarëve në ushtrimin e detyrës së tyre?

Sa i përket mekanizmave që ofrojnë siguri mendoj se në këtë drejtim jemi më pak të organizuar pasi që gjyqtari përveç në gjykatë nuk ka ndonjë mekanizëm që do të ofroj siguri jashtë gjykatës. Ne jemi gjyqtarë 24 orë në ditë me sjellje, qëndrim dhe stil të jetës dhe kjo duhet të mbrohet dhe të ofrohet një siguri më e madhe në realizim të këtyre synimeve.

5. Çfarë duhet bërë që të forcohet besimi qytetar ndaj Gjykatës?

Që të forcohet besimi i qytetarëve duhet të punohet me përkushtim, të merren vendime të drejta të bazuara në ligj dhe në kohë të arsyeshme. Këto vendime të jenë transparente dhe njoftohen qytetarët sa më shumë me punën e gjykatës dhe me ecurinë e punëve të cilat kryen në gjykatë sepse vetëm me punë forcohet besimi.

SI T'I QASEMI GJYKATËS?

Si caktohen dhe ndahen lëndët?

Shpërndarja e lëndëve tek gjyqtarët bëhet me short. Të gjitha lëndët e pranura ndahen në grumbuj sipas numrit të gjyqtarëve dhe llojit të lëmisë juridike gjyqësore. Mbi çdo grumbull të lëndëve vihet një procesverbal në të cilin përshkruhet numri dhe lloji i lëndëve të cilat do të tërhiqen nga gjyqtari të cilit i bie shorti.



Ruajtja e konfidencialitetit

1. Të gjithë të punësuarit dhe të angazhuarit në gjykatë kanë për detyrë ta ruajnë sekretin zyrtar për të cilin kanë mësuar gjatë punës në gjykatë.
2. Sekret zyrtar konsiderohen të dhënat, informatat dhe dokumentet tjera jopublike të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.



A e dini se...?!

LIGJI Nr.2004/26 Për trashëgimi, Neni 11

- Të gjithë personat fizikë në kushte të njejta janë të barabartë në trashëgimi. (LIGJI Nr.2004/26 Për trashëgimi, Neni 3, Paragrafi 1).
- Trashëgimtarë ligjorë janë: fëmijët e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, bashkëshorti, prindërit, vëllzërit e motrat dhe pasardhësit e tyre, gjyshi e gjyshja dhe pasardhësit e tyre.



KODI Nr. 03/L-193, LIGJI I DREJTËSISË PËR TË MITUR, Neni 27

Dërgimi në institucionin edukativ

1. Gjykata e shqipton masën e dërgimit në institucionin edukativ kur të miturit i nevojitet mbikëqyrje e plotë nga edukatorët adekuat dhe kur masa e tillë është në interesin më të mirë të miturit.
2. Kohëzgjatja e kësaj mase nuk mund të jetë më e shkurtër se tre (3) muaj apo më e gjatë se dy (2) vjet.





Kontaktoni
Gjykatën Themelore
të Prizrenit

Zyra e Administratës
Tel: +381 (0) 29/244 122

Adresa:
Gjykata Themelore
e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu",
p.n. Prizren, Kosovë

Vizito:
www.gjyqesori-rks.org



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU
PRIZREN TEMEL MAHKEMESI
BASIC COURT OF PRIZREN

Ky publikim është rezultat i Gjykatës Themelore të Prizrenit